



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.

Gramsh më ___/___/2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E
HAPUR E THJESHTUAR – MALLRA”**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"Blerje mjete transporti fuoristradë për Bashkinë Gramsh";

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Automjete 34100000 - 8

VLERA E FONDIT LIMIT:

6,249,986 (gjashte milion e dyqinde e dyzete e nente mije e nenteqind e tetedhete e gjashte) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gramsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin e **maturuar** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben

Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 5(pesë) persona. të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 të paktën minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, prej te cileve 1 (nje) person duhet te jete i pajisur me DAP si me poshte:.

- Dëshmi Aftësie Profesionale si përgjegjes teknik te aktivitetit te autoriparimit
- Kontrata e punes e noterizuar

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari dorëzon dokumentat provues si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”,

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur bazuar në sasinë e mallrave të caktuara napreventiv dhe numrin e nevojshëm të mjeteve që kemi kërkuar nga operatori ekonomika. Shoferët janë të nevojshëm për transportimin e mallrave me mjetet nga operatori ekonomik drejtvendit të caktuar nga autoriteti kontraktor. Punonjësit e tjerë është parë e arsyeshme të kërkohen pasi duhet të merren me ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave.

2.5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit:

- **ISO 9001- 2015** ose ekuivalente (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mjedisit e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset

mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalog për mjetet**, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e mjeteve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar, 10 dite nga data e lidhjes së kontratës.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor. Afati i vendosur për dorëzimin e mallit justifikohet me nevojën e madhe që ka AK për këto mjete, relievi i Bashkisë Gramsh dhe kushte të tjera infrastrukturore ...etj.

2.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Nr. shasie etj.
1			
Etj.,			

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.9. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë garancinë, 3(tre) muaj nga dita marrjes ne dorezim te mjeteve objekt prokurimi te cila duhet të jene sipas specifikimeve teknike. Gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike. Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të garancisë, operatori ekonomik duhet të ketë dhe te paraqes listën e serviseve në pronësi, me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi si me poshte:

- Kontratën e qerasë / huapërdorjes / QKB ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet riparimi, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë.

2.10. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se ne momentin e dorezimit automjetet duhet te jene te taguara, te kolauduara dhe tasken vjetore te paguar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe me dokumentacionin minimal te nevojshem. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet riparimi, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë.

2.11. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit te prokurimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

FUORISTRADA

NR	TE DHENAT	PERSHKRIMI
1	Numri dyerve	Jo me pak se 5
2	Numri vendeve	Jo me pak se 5
3	Fuqi motorike	126-140 KV
4	Viti prodhimit	Jo me i vjeter se 2006
5	Cilindrat Motorri	2900-3000 CM ³
6	Trasmisioni	Preferohet automatike

7	Kilometrazhi	Jo me shume se 270,000 km
8	Karburanti	Nafte
9	Dokumentacioni	Targuar, Kolauduar dhe Taksa vjetore ne momentin e dorezimit
10	Klima	PO
11	Ganxhe terheqese	PO
12	Origjina e mallit	Te jete i importuar nga vendet europiane
13	Pesha bosh	2000-2300 Kg
14	Pesha plote	2800-3000
15	Gjatesia	4050 - 5020 cm
16	Gjeresia	180-190 cm

FUORISTRADË ME KARROCERI

NR	TE DHENAT	PERSHKRIMI
1	Numri dyerve	Jo me pak se 4
2	Numri vendeve	Jo me pak se 5
3	Fuqi motorike	126-140 KV
4	Viti prodhimit	Jo me i vjeter se 2012
5	Cilindrat Motorri	2900-3000 CM ³
6	Trasmisioni	Preferohet automatike
7	Kilometrazhi	Jo me shume se 270,000 km
8	Karburanti	Nafte
9	Dokumentacioni	Targuar, Kolauduar dhe Taksa vjetore ne momentin e dorezimit
10	Klima	PO
11	Ganxhe terheqese	PO
12	Origjina e mallit	Te jete i importuar nga vendet europiane
13	Pesha bosh	1900-2100 Kg
14	Pesha plote	2700-2900
15	Gjatesia	5000 - 5050 cm
16	Gjeresia	180-190 cm

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi pa tvsh	Vlera
1	Fuoristrade	Cope	2		
2	Fuoristrade me karrocери	Cope	2		
	Shuma pa TVSH				
	TVSH				
	Shuma me TVSH				

Afatet e lëvrimit: 10 dite nga data e lidhjes se kontrates.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Fuoristrade	2 cop	Bashkia Gramsh	10 dite nga data e lidhjes se kontrates.
2	Fuoristrade me karrocери	2 cop	Bashkia Gramsh	10 dite nga data e lidhjes se kontrates.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me me Urdhërin e Zyrtarit të Autorizuar N/Kryetarit të Bashkisë nr.396, datë 15.11.2024 Ngritjen e Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e Fondit Limit për objektin e prokurimit “Blerje kompjutera dhe printer”.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

ANËTAR
Erionilda MIRAKA

ANËTAR
Julian MUHA

ZYRTARI I AUTORIZUAR
N/KRYETARI I BASHKISË
Tajar BICI

Konceptoi: Njesia
Miratoi: T.Bici
Konfirmoi:
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: _____